



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 70 Akti

Nr. 72 Vendimi

Tiranë, më 31.10.2018

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 3 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi

Kryesuese

Suela Zhegu

Anëtare

Valbona Sanxhaktari

Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 30 tetor 2018, ora 12:00, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Sokol Stojani, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, i pranishëm në seancën dëgjimore.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi dokumentacionin në dosjen e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Sokol Stojani është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 15.01.2018.

2. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

3. Me vendimin e trupit gjykues, datë 24.01.2018, është caktuar kryesuese znj. Brunilda Bekteshi, si dhe është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

4. Më datë 31.05.2018 është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit, ndërsa subjekti ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Më datë 17.10.2018, trupi gjykues, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. Trupi gjykues ngarkoi relatorin e çështjes për të njoftuar subjektin e rivlerësimit.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj. Ai paraqiti parashtimet e tij lidhur me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani, në seancë dëgjimore, më datë 30.10.2018, ora 12:00, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.10.2018, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent, ai dha shpjegimet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

11. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- i) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- ii) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- iii) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, së bashku me materialin shoqërues;
- iv) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- v) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- vi) Denoncimet nga publiku;
- vii) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- viii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore.

12. Në mbështetje të dispozitave kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nr. 2 dhe nr. 78, të vitit 2017.

A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në

bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

13.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion në raportin e tij ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

14. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

14.1 Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuritë si vijon:

15. Ap. banimi, Rr. “(*)”, pallati “(***)”, Tiranë**, me sip.128 m², kati (***) , ap. (***) , Tiranë, blerë në vitin 2002, vlera e deklaruar 5.000.000 lekë, pjesa takuese 100 %.

16. Burimi i krijimit: Kredi 5.000.000 lekë në Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”) me kontratë huaje nr. (***) rep., dhe nr. (***)kol., datë 11.01.2002, me afat shlyerjeje 25 vite.

Si burim i dytë për arredimin e banesës deklarohet nga subjekti i rivlerësimit shitja e apartamentit të nënës me kontratën nr. (***) rep., dhe nr. (***) kol., datë 16.04.2002, në vlerën 3.000.000 lekë, në adresën: njësia administrative nr. 2, Rr. “(***)”, pall. (***) , shk. (***) , ap. (***) , Tiranë.

17. Mënyra e fitimit të pasurisë së paluajtshme është me kontratë sipërmarrjeje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 14.12.2001, kontratë (me kusht kreditimi) ndërmjet firmës “(***)” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, për vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

Subjekti ka paraqitur kontratë dorëzanie nr. (***) rep., nr. (***) kol, datë 14.01.2002, ku dorëzanës është z. B. M. (administratori i firmës “(***)”, huamarrës z. Sokol Stojani dhe huadhënës Dega e Bankës së Kursimeve -Tirana 1.

Hetimi i kryer nga Komisioni

18. Në deklaratën “Vetting” është deklaruar Ap. banimi, Rr. “(***)”, pallati “(***)”, Tiranë, me sip.128 m², pjesa takuese 100 %. Kontratat përkatëse lidhur me këtë pasuri, si ajo e porosisë dhe ajo e shitblerjes, janë të nënshkuara nga vetë subjekti i rivlerësimit.

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

19. Kontrata e huas për blerje banese, me nr. (***) rep. dhe nr. (***) kol., datë 11.01.2002, realizuar para kontratës së shitjes, bazohet në shkresën nr. (***), datë 20.03.2001, të Këshillit të Ministrave, firmosur nga Kryeministri i kohës, ku shpjegohet se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, është përcaktuar si përfitues i kredisë, mbështetur në Vendimin nr. 102, datë 05.03.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, (*aktualisht i shfuqizuar*).

20. Kontrata e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 23.07.2002, është lidhur ndërmjet palës shitëse, shoqërisë “(***)” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori z. B. M. dhe z. Sokol Stojani, për vlerën e përcaktuar 5.000.000 lekë e cila është kaluar nga subjekti i rivlerësimit në favor të firmës ndërtuese në llogarinë e saj në “Bankën Amerikane”.

21. Komisioni i drejtuar² “Raiffeisen Bank”, duke kërkuar praktikën e kredisë. Nga kjo bankë është kthyer përgjigje³, ku shpjegohet se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, është përcaktuar si përfitues i kredisë, në shkresën nr. (***), datë 20.03.2001, të Këshillit të Ministrave, firmosur nga Kryeministri i kohës.

22. ZVRPP-ja Tiranë⁴, konfirmon në emër të subjektit të rivlerësimit pasurinë apartament me sipërfaqe 128 m² (*pasuri aktive*). Në seksionin D të kartelës është regjistruar shënimi: “*pasuria bllokohet në favor të Banka e Kursimeve për shumën 5.000.000 lekë*”.

23. Për arredimin e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga apartamenti me sipërfaqe 65.8 m², ndodhur në Rr. “(***)”, pall. (***), ap. (***), Tiranë, shitur nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Të ardhurat në vlerën 3.000.000 lekë janë përdorur për arredimin e apartamentit të banimit në Rr. “(***)”, pallati “(***)”, Tiranë, me sip.128 m².

24. Ky apartament është përfituar nga e ëma e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës së shitblerjes së vitit 1993 midis Ndërmarrjes Komunale Banesa Nr. 1 dhe blerëses znj. K. S., me vlerë shitjeje 18.620 lekë (*kontratë për privatizimin e banesës, datë 24.08.1993 ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe znj. K. S.*).

25. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie të datës 16 prill 2002, pasuria nr.(***), vol(***), fq. (***), është e regjistruar në emër të znj. K. S.

26. Kjo pasuri është shitur me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 16.04.2002, me shitës K., Sokol dhe A. Stojani (*ky i fundit i përfaqësuar me prokurë nga e ëma*) dhe blerësit A. M., në vlerën 3.000.000 lekë.

27. Me prokurën e posaçme, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.04.2002, z. A. S., i jep të drejtat për përfaqësim dhe nënshkrim të kontratës së shitjes për apartamentin e nënës së tij, duke hequr dorë nga e drejta e pronësisë mbi këtë apartament.

28. Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. K. S., ka jetuar me dy djemtë e saj Sokol dhe A. S. Që prej vitit 1986 djali i saj A. S. është larguar me studime në Francë dhe nuk është kthyer më për të jetuar në Shqipëri. Kështu znj. K. S. ka jetuar me subjektin e rivlerësimit fillimisht në shtëpinë e saj dhe aktualisht ajo jeton me të dhe familjen e tij në shtëpinë e blerë nga djali Sokoli. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka deklaruar se e ka arreduar shtëpinë me paratë e fituara nga shitja e apartamentit më sipër, i cili ka qenë 1/3-ta pjesë e tij dhe 2/3-ta pjesë e nënës.

² Shkresë nr. (***) prot., datë 17.04.2018.

³ Shkresë nr. (***) prot., datë 26.04.2018.

⁴ Shkresa nr. (***) prot., datë 15.03.2018.

29. Në shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai ishte pjesë e një grupi hetimor ngritur për ngjarje të rëndësishme të ndodhura në vitet 1999 dhe se një pjesë e prokurorëve dhe OPGJ-ve të çështjes jetonin për kohën në zona të vështira apo dhe informale ku, si lëvizja e prokurorëve të cilët punonin deri natën vonë, ashtu dhe lëvizja e familjarëve, krijonte problematikë në mënyrën e jetesës dhe kufizimit të lirisë së tyre, pasi ruajtja në zonat ku ato banonin përbënte vështirësi të madhe nga forcat e rendit dhe kërkonte shumë më tepër shpenzime e masa sigurie.

Ndërkohë, qeveria mori masa më të forta sigurie në ruajtjen fizike të anëtarëve të grupit hetimor dhe familjeve të tyre nëpërmjet forcave speciale të policisë dhe, si pjesë e mbështetjes për krijimin e kushteve të sigurisë dhe një standardi normal jetese, në mars të vitit 2001 nxori për zbatim dhe praktikën për pajisjen me kredi për prokurorët dhe OPGJ-të e grupit hetimor, përfshi edhe subjektin e rivlerësimit.

Kështu, në fund të 2001-shit, në momentin e lëvrimit të kredisë u likuidua edhe shoqëria e ndërtimit, dhe vetëm pas rreth 4 muajsh, nëna vendosi të jetojë me subjektin e rivlerësimit dhe ta shiste shtëpinë e saj.

30. Nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet vetëm kjo pasuri e transkriptuar, në emër të znj. K. S. dhe asnjë pasuri aktive. Nga hetimi nuk figurojnë pasuri të tjera të paluajtshme aktuale apo të tjetërsuara në emër të znj. K. S.

31. Në emër të E., H. dhe E. S. nuk figurojnë pasuri të paluajtshme aktuale apo të tjetërsuara.

32. Në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, nuk figurojnë pasuri të tjera të paluajtshme aktuale apo të tjetërsuara.

33. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, rezulton të ketë detyrime financiare nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve (sot “Raiffeisen Bank”), në shumën 5.000.000 lekë në vitin 2002. Nga vlerësimi i bërë në “Raiffeisen Bank” për periudhën pas datës 01.01.2017 deri 17.01.2027, rezulton shuma e detyrimit financiar që mbetet për t’u likuiduar në masën 2.473.166 lekë.

34. Në përfundim të hetimit rezulton se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

35. Automjet tip “Nissan”, prodhim i vitit 2008, blerë më datë 10 janar 2017, me targa (***). Vlera e deklaruar: 4.700 euro.

36. Burim i krijimit: Kursimet e familjes ndër vite, të ruajtura në *cash*, që janë përfituar nga të ardhurat e deklaruara.

37. DPSHTRR-ja me shkresën nr. (***), datë 11.05.2018, ka dërguar dosjen e plotë të automjetit tip “Nissan Qashqai”, me targë (***). Konfirmohet blerja nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 10.01.2017, nga shtetasi A. S., në vlerën 4.700 euro.

37.1 Dosja e dërguar konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin tip “Renault Megane”, viti i prodhimit 1997, i shitur me kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 21.09.2015, në vlerën 130.000 lekë. Automjeti “Renault Megane” është blerë në vitin 2006, për vlerën 150.000 lekë (pa përfshirë detyrimet doganore dhe detyrime të tjera të lidhura me regjistrimin dhe targimin e këtij automjeti).

38. Në deklarinimin periodik vjetor (para fillimit të detyrës) subjekti ka deklaruar një makinë tip “Reno Clio”, për vlerën 2.000.000 lekë, të cilën e ka shitur në vitin 2006 për vlerën 250.000

lekë. Nga hetimi rezultoi se vlera prej 2.000.000 lekësh në deklarinimin fillestar ka qenë me lekë të vjetër, mbështetur edhe në sqarimet e subjektit të rivlerësimit.

39. Në verifikimi në faqen e Autoritetit të Mbikëqytjes Financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë përdorues i automjeteve të mëposhtme sipas policave të sigurimit:

- Automjet tip “Nissan Qashqai”, me targë (***), ngjyra gri, viti i prodhimit 2008;
- Automjet tip “Renault” (*Jaono 5, Megane*), me targë (***), ngjyra gri, viti i prodhimit 1997.

40. Është verifikuar në sistemin *TIMS* lidhur me personat që kanë vënë në përdorim automjetet e tyre për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

- **Z. A. P. D.**, i datëlindjes 15.12.1968, djali i tezes së subjektit të rivlerësimit, pronar i mjetit tip “Opel”, me targë TR (***).
- **Z. A. Gj. S.**, i datëlindjes 06.08.1979, kushëriri i subjektit të rivlerësimit, pronar (*nga korriku i vitit 2013 deri në 10 janar 2017*) i mjetit tip “Nissan”, me targë (***) (*nga korriku i vitit 2013 deri në 10 janar 2017*).
- **Z. A. S. B.**, i datëlindjes 17.05.1973, pronar i mjetit tip “Audi”, me targë (***).
- **Z. B. C.**, pronar i mjetit me targë (***).

40.1 Nga verifikimet në sistemin *TIMS*, personat e lartpërmendur nuk kanë regjistrime për përfshirjen e tyre në veprime të kundërligjshme.

41. Llogari të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit:

Llogaria e kartës së kreditit (AMEX) në euro, në “Credins Bank”:	677.44 euro
Llogaria e kartës së kreditit (Visa) në lekë, në “Credins Bank”:	32.709 lekë
Llogaria kartë/debiti (elektronik Visa) në lekë, në “Credins Bank”:	30.323,24 lekë
Llogari rrjedhëse në lekë në “Raiffeisen Bank”:	7,6 lekë
Llogari rrjedhëse në “ProCredit Bank” (mbyllur 09.01.2017):	134,7 euro

42. Gjendje *cash* e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit: Kursime të mbetura gjendje në *cash* në momentin e deklarinimit, të mbajtura në banesë, vlera 2.000 euro dhe 2.000 USD.

43. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E. S. (F.), deklaron:

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, më datë 01.01.2017, duke përfshirë edhe <i>overdraft</i> deri në shumën 120.000 lekë:	- 95.427 lekë
Llogari në euro në “Raiffeisen Bank”, më datë 01.01.2017:	0,02 euro
Llogari në euro në :Raiffeisen Bank”, më datë 01.01.2017:	11,80 euro
Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, deri më datë 01.01.2017:	96,49 lekë.

44. Nga hetimi administrativ mbi pasurinë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur rezulton se përputhen deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ardhura nga “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank”.

45. Rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë ato nga pagat dhe shpërblimet si prokuror, të ardhurat nga Këshilli i Prokurorisë, si dhe të ardhurat nga pjesëmarrja në Këshillin Pedagogjik në Shkollën e Magjistraturës. Ndërsa për bashkëshorten e tij të ardhurat janë nga paga si pedagoge në Akademinë e Arteve, në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe të ardhura nga punësimi në KESH më herët.

46. U verifikuan udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat rezultuan mesatarisht mesatarisht 1 - 3 udhëtime në vit me familjen.

47. Nga analiza financiare u konstatua se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, justifikon plotësisht shpenzimet jetësore familjare të kryera ndër vite dhe se ato janë të mbuluara plotësisht nga të ardhura nga burimet e ligjshme.

Dhurata të përfituara nga nëna e subjektit të rivlerësimit

48. Vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A. S., jeton në Francë që prej vitit 1986. Nga subjekti deklarohen të ardhura nga vëllai, për nënën, në vlerën 57.956 euro gjatë viteve 2000 - 2016.

49. Nga hetimi konstatohet se këto të ardhura janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore. Ato janë konfirmuar nëpërmjet sistemit bankar (*referuar nxjerrjes së llogarive në "ProCredit Bank" për periudhën 2002 - 2016 dhe transfertave nëpërmjet Bankës së Kursimeve për periudhën 2000 - 2001*). Paratë kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar në formën e një pensioni mujor për nënën e subjektit të rivlerësimit.

50. Subjekti i rivlerësimit ka shoqëruar me dokumentacion ligjor të ardhurat e vëllait të tij në Francë, të cilat ishin mjaftueshëm të konsiderueshme, për të dërguar të ardhura për nënën, që variojnë mesatarisht nga 2.500 - 5.000 euro në vit. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion justifikues që provon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të vëllait të tij. Ai ka dokumentuar se, z. A. S., ka pasur të ardhura bruto në vlerën 7.098 euro në muaj, si i punësuar prej datës 01.01.1999, pranë "Shoqërisë (***)", në detyrën e përgjegjës të departamentit.

51. Hetimi administrativ kryesisht i kryer nga Komisioni u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

52. Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë.

53. Nuk rezulton nga ndonjë burim që ky subjekt të ketë pasuri të paluajtshme, të fshehura apo të padeklaruara, të mbajtura nga persona të tjerë.

54. Subjektit të rivlerësimit iu dërgua nëpërmjet adresës zyrtare të *e-mail*-it edhe një pyetësor-tip dhe nga përgjigjet e këtij pyetësori, deklaratimet rezultuan të ishin korrekte dhe në përputhje me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

55. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se: Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Ai ka kryer deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaratim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

56. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

57. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin nr. (***) prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani”. Ky raport është i deklasifikuar.

57.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

58. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

59. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

60. Prokuroria e Përgjithshme, në cilësinë e organit ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

60.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ai shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti shfaq njohuri të mira në njohjen e vendimeve përkatëse të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi në të gjitha aktet e tij gjenden referime për situata të ngjashme nga këto vendime.

b) Arsyetimi ligjor

60.2 Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

60.3 Në analizë të të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

60.4 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë organizative të treguara prej tij, pasi ka përballuar ngarkesë pune voluminoze me cilësi dhe shpejtësi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

60.5 Në funksion të detyrës, subjekti nuk ka administruar dosje hetimore, por në të gjitha rastet e përfaqësimit të tij në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese mendimi i tij ka qenë parapërgatitur në kohë dhe me shkrim për çdo seancë gjyqësore të zhvilluar.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

60.6 Nga verifikimi pranë sektorit të burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e vlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

60.7 Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të raportit, për subjektin e rivlerësimit, Sokol Stojani nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.

c) Paanësia

60.8 Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani, për periudhën objekt vlerësimi, nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në çështjet penale që i janë ngarkuar, apo të ketë pasur cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces dhe grupeve shoqërore të tjera.

61. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, është prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Z. Sokol Stojani mbante detyrën drejtorit të Drejtorisë së Ndihmës për Subjektet e Posaçme, Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, Studimeve, Projekteve. Nga kjo detyrë ai është larguar me kërkesën e tij. Me shkresën nr. (***) , datë 09.10.2018, nga Prokuroria e Përgjithshme është dërguar urdhri nr. (***) , datë 19.09.2018, “*Për lirimin nga detyra të drejtuesit*”.

TË DHËNA ARKIVORE (kallëzime, ankesa, masa disiplinore, vlerësime)

62. Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, të ketë pasur masa disiplinore apo ndaj tij të jenë depozituar ankesa lidhur me punën e kryer.

63. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme u gjetën 3 vlerësime të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani, të cilat i përkasin punës së tij për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016.

64. Nga verifikimi në të gjitha Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka pasur tri kallëzime:

*64.1 Kallëzimi penal nr. (***) , datë 25.11.2015, i regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës*

Kallëzimi është bërë nga ana e shtetasit N. L., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Lidhur me këtë kallëzim, më datë 26.11.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin e hetimeve me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në gjykatë

kallëzuesi N. L. Me vendimin nr. (***) , datë 16.05.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të datës 26.11.2015 dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Për këtë fakt, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. (***) , datë 08.06.2016, për veprën penale “Shpërdorim detyre”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Prokuroria e Durrësit, me vendimin e datës 22.09.2016 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. (***) , datë 08.06.2016, bazuar ne nenin 328, pika 1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në kallëzimin e tij, shtetasi N. L. ka kërkuar ndjekjen penale ndaj prokurorëve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë: Sokol Stojani, Gj. K. dhe E. K., për veprën penale “Shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për shkak të vendimeve të mara prej tyre në cilësinë e prokurorit të ngarkuar për hetimin e procedimit penal nr. (***) të vitit 2006, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*64.2 Kallëzimi penal nr. (***) , datë 27.03.2009, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*

Kallëzimi është bërë nga ana e shtetasit F. M. dhe është depozituar më datë 24.03.2009 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shtetasi F. M. ka kallëzuar faktin se më datë 19 mars 2009 ai ka qenë i ftuar në emisionin “Opinion” në televizionin “Klan”. Sipas tij, prokurori Sokol Stojani ka komunikuar me SMS me gazetarët që kanë qenë pjesë e panelit të emisionit, ku ka qenë i ftuar kallëzuesi F. M. Në këto komunikime ai u ka sugjeruar gazetarëve pyetje publike. Këtë veprim, kallëzuesi e konsideron si vepër penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 21.04.2009 ka vendosur “Mosfillmin e procedimit penal nr. (***) , datë 27.03.2009”, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

64.2.1 Lidhur me këtë kallëzim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar:

“Ky kallëzim nuk ishte rrufe në qiell të pastër, por pjesë e një strategjie për të dëmtuar kompaktin dhe kredibilitetin publik të grupit të hetimit, nëpërmjet shantazhimit e baltosjes së figurës, apo dhe duke përdorur truke procedurale. ...

Duke ngritur pretendime -që në fakt nuk mund të konsideroheshin si shkaqe ligjore, - ish-ministri i proceduar penalisht prej nesh synonte të vepronte taktikisht me kërkesa procedurale, që t’i imponohej Prokurorit të Përgjithshëm, por dhe mua si drejtues i hetimeve ndaj tij për të dhënë dorëheqjen nga çështja apo për ta përdorur si shkak ligjor për zëvendësimin tim nga grupi i hetimit dhe mosinformimin e Prokurorit të Përgjithshëm rreth gjendjes së procesit hetimor, me argumentin e konfliktit të interesit.

Duke i vlerësuar me seriozitet situatat dhe mjetet e përdorura nga ish-ministri etj., duke mbajtur parasysh interesat e mbarëvajtjes së hetimit të çështjes, në mënyrë që të mos cenohet uniteti i grupit pas një dorëheqjeje tjetër, që në thelb do ishte komoditet si për Prokurorin e Përgjithshëm, ashtu dhe për mua personalisht, morëm përsipër përgjegjësitë dhe natyrisht që dhe unë refuzova dorëheqjen, duke i rrëzuar shkaqet për përjashtim si të pabazuara ligjërisht. Ndërkohë, lidhur me kallëzimin ndaj meje ka vendosur prokurori i çështjes, vendim i cili është tashmë i formës së prerë dhe i pacenueshëm ligjërisht.”

*64.3 Kallëzimi penal nr. (***) , i datës 03.01.2013, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*

Kallëzimi është bërë nga ana e shtetasit T. D. ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, F. B., drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe A. Q., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë. Shtetasi T. D. ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin deri në datën 02.09.2009, kur është shkarkuar me dekret të Presidentit të Republikës. Nga ana e kallëzuesit

pretendohet se ndaj tij ka nisur një procedim penal i paligjshëm në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe se këtë procedim e ka iniciuar subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale, me shkresën nr. (***) , datë 10.07.2009, i ka përcjellë Prokurorisë Krujë informacionin e Prokurorisë Kurbin për shkelje ligjore të kallëzuesit T. D. në një procedim të ndjekur prej tij. Bashkëlidhur, gjithashtu, i ka dërguar Urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin nga detyra të kallëzuesit. Ky i fundit ka pretenduar se nga ana e z. Sokol Stojani është sajuar i gjithë procedimi në ngarkim të tij. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me kallëzimin e mësipërm ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç”, dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

64.3.1 Lidhur me këtë kallëzim, subjekti i rivlerësimit sqaron se:

“Në vlerësimin tim ka pasur doza emocionale, pasi unë kam qenë me cilësinë e anëtarit dhe kryetarit të Këshillit të Prokurorisë në atë periudhë (2008 - 2011), kur është rekomanduar shkarkimi i tij nga detyra.

Në lidhje më faktin që kallëzon z. T. D., shpjegoj që unë, në cilësinë e drejtorit të hetimit, kam përcjellë administrativisht një informacion për kompetencë vlerësimi dhe trajtimi procedural, nëse kishte apo jo elemente të veprës penale një fakt që më ishte bërë prezent nga Prokuroria e Kurbinut dhe, në mos gabohem dhe nga Policia e Shtetit, sipas të cilit rezultonte se z. T. D., edhe pse ishte pezulluar nga detyra, i kishte dhënë leje të lëvizte lirshëm në publik një të pandehuri me masë sigurimi “arrest në shtëpi”.

DENONCIME TË PARAQITURA PRANË KOMISIONIT

Pranë Komisionit janë paraqitur 7 denoncime për subjektin e rivlerësimit, si më poshtë vijon:

Ankesa 1

*65. Denoncimi nr. (***) prot., datë 24.11.2017.*

Ky denoncim u referohet pesë subjekteve të rivlerësimit. Ankuesi i referohet faktit se prokurori Sokol Stojani, gjatë kohës kur ushtronte detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. (***) të vitit 2006.

Ankuesi pretendon se vajza e tij, V. L., ka gjetur vdekjen nga ish-i fejuari i saj, A. N., jo si pasojë e një aksidenti automobilistik. Familjarët pretendojnë se viktimi ka qenë e keqtrajtuar dhe e dhunuar fizikisht përpara se të ndodhte aksidenti automobilistik dhe kanë kërkuar kryerjen e akteve të ekspertimit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. (***) , datë 04.08.2006, sipas nenit 328/1, germa “dh” të Kodit të Procedurës Penale, i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai.

Me kërkesë të familjarëve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të organit të Prokurorisë me nr. (***) të vitit 2006 dhe vazhdimin e hetimeve të mëtejshme nga ana e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. (***) akti, datë 08.02.2008.

Me vendimin nr. (***) , datë 26.07.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit A. N. për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen dhe dënimin e tij me 1 (një vit) e 6 muaj burgim, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. (***) , datë 12.04.2013.

Nga raporti profesional i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton gjithashtu se N. L. ka paraqitur kallëzimin penal nr. (***) , datë 25.11.2015, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani.

Lidhur me këtë kallëzim, më datë 26.11.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e hetimeve, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatë kallëzuesi N. L.. Me vendimin nr. (***), datë 16.05.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të datës 26.11.2015 dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Për këtë fakt, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur regjistrimi i procedimit penal nr. (***), datë 08.06.2016, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Kjo prokurori, me vendimin e datës 22.09.2016 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 993, datë 08.06.2016, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

Pas shqyrtimit të dosjes penale, konstatohet se:

Oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit autoteknik. Ky ekspertim është kryer më datë 29.05.2006 nga një ekspert autoteknik.

Nga akti i ekspertimit rezulton se pyetjes: *“A konstatohen shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të mjetit ‘Benz’, veturë me targë (***) dhe nëse po, cilat janë ato?”*

Eksperti i përgjigjet se: *“Nga ana e drejtuesit të mjetit me targë (***) është shkelur neni 139/2 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, sipas Kodit Rrugor: “Drejtuesi i mjetit duhet të ruajë gjithmonë kontrollin e mjetit dhe të jetë në gjendje të kryejë të gjitha manovrat e nevojshme të mjetit brenda kufijve të fushëpamjes dhe përpara çdo pengese të mundshme.”*

Pyetjes cili është shkaku i aksidentit, eksperti i përgjigjet: *“Shkaku i ndodhjes së aksidentit është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor dhe pikërisht e nenit të lartpërmendur të Kodit Rrugor.”*

Prokurori Sokol Stojani, më datë 6 korrik 2006 ka marrë vendim për marrjen në shqyrtim të memories së avokatit të të pandehurit, A. N., i cili ka kërkuar pavlefshmërinë e aktit të ekspertimit auto-teknik të datës 29.05.2006, me pretendimin se është kryer në kundërshtim me nenin 179, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale, që lidhen me mënyrën e caktimit të ekspertit dhe procedurën e njoftimit të të pandehurit ose mbrojtësit të tij.

Prokurori ka vendosur pranimin e kërkesave të parashtruara në memorie, duke e deklaruar si të papërdorshëm dhe për pasojë të pavlefshëm aktin e ekspertimit auto-teknik të datës 29.05.2006, me arsyetimin se ekspertimi është një veprim hetimor me pasojë pavlefshmërinë në rast mosrespektimi të kërkesave të nenit 179/2 dhe 183/1 të Kodit të Procedurës Penale që lidhen me pakujdesitë e konstatuara lidhur me njoftimin e të drejtave që ka i pandehuri në kryerjen e një ekspertimi dhe të vetë atij për kryerjen e këtij veprimi, si dhe rezervat lidhur me aktin e parë të ekspertimit.

Më datë 7 korrik, prokurori ka marrë vendim për kryerjen e riekspertimit auto-teknik.

Mbështetur në këtë vendim është kryer akti i ekspertimit auto-teknik më datë 12.07.2006, i cili ka konkluduar se nga ana e drejtuesit të mjetit nuk konstatohen shkelje të normave të qarkullimit rrugor, dalja nga rruga e tij ka ardhur si pasojë e kushteve në nevojë ekstreme nga drejtuesi i mjetit.

Është mbajtur edhe një procesverbal për njohjen e të pandehurit A. N. me aktin e riekspertimit auto-teknik.

Babai i viktimës, N. L. është pyetur më datë 13 korrik 2006, ora 9:00, sipas procesverbalit përkatës që është mbajtur për këtë qëllim.

Prokurori Sokol Stojani ka vendosur pushimin e çështjes nr. (***) të vitit 2006 në ngarkim të të pandehurit A. N. N., mbështetur në nenin 328, pika 1, germa “dh”, të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se në çdo fazë të procedimit prokurori vendos pushimin e çështjes kur “del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. (***) akti, datë 08.02.2008, çmon se duhet të priset vendimi i pushimit nr. (***), datë 04.08.200, dhe çështja t’i kthehet organit të Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme.

65.1 Subjekti sqaron:

“Në mënyrë të përmbledhur ngjarja ka ndodhur në këto rrethana: Më datë 29.05.2006, rreth orës 12:00, autovetura e drejtuar nga shtetasi A. N., brenda së cilës ka qenë dhe e fejuara e tij, e ndjera V. N. L., duke udhëtuar në autostradë me drejtimin Tiranë - Durrës, është përplasur në këmbën e mbikalimit të këmbësorëve në autostradë, që ndodhet pikërisht para zyrave qendrore të shoqërisë “Vodafone Albania”, pa shkuar te Qendra Tregtare Univers (QTU), si pasojë e së cilës ka gjetur vdekjen shtetasi V. L. dhe ka pësuar dëmtime drejtuesi i mjetit, shtetasi A. N.

Policia Gjyqësore ka kryer të gjitha veprimet e para hetimore, ka realizuar ekspertimin autoteknik, si dhe i është bërë autopsia së ndjerës dhe ekzaminimi mjekoligjor i drejtuesit të mjetit.

*Për këtë ngjarje, mbi materialet e arrestit në flagrancë të shtetasit A. N., të sjella nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Komisarariatit Rrugor, më datë 30.05.2006, Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. (***), për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen e shtetases V. L.*

Pasi është marrë masa e sigurimit personal nga gjykata, çështja më vonë më është caktuar mua. Nga ana ime janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, përfshi këtu edhe pyetjen e babait të së ndjerës dhe në përfundim kam vendosur të pushoj çështjen, me argumentin se drejtuesit të mjetit i është shfaqur një burim rreziku (pretendohet dalja e papritur e një qytetari), çka e justifikon veprimin e një manovrimi shumë të shpejtë me sterçim timoni, ku si pasojë është përplasur me shtyllën e mbikalimit.

Mekanizmi i ngjarjes tregon se vetëm nëse do të kishte motiv t’i jepte fund dhe jetës së tij, drejtuesi i mjetit mund të kryente atë lloj manovre, sepse natyra e goditjes në mes të makinës me shtyllën dhe ardhjen e dëmtimit deri te korskoti, tregon se askush nuk mund të garantonte që nga kjo përplasje përjashtohet rreziku i jetës së drejtuesit të mjetit.

Duke parë vendimin tim për pushimin e çështjes, si dhe duke iu referuar memories sime, më rezultoi se i kam trajtuar të gjitha pretendimet e ngritura nga babai i të ndjerës, duke i bërë të njohura arsyet se përse ato nuk ishin bindëse dhe nuk mund të merreshin në konsideratë.

Këtë vendim pushimi, që mban datën 04.08.2006, prind i viktimës e ka ankimuar në gjykatë dhe kjo e fundit, pavarësisht pretendimeve të tij, e pa të arsyeshme ta shfuqizojë vendimin tim, jo për argumentet e kërkuarit, por për faktin se meqenëse ishin 2 ekspertime autoteknike të ndryshme, të bëhej dhe një i tretë.

Gjithsesi, për të shmangur çfarëdo lloj paragjykimi, jam tërhequr nga hetimi i mëtejshëm me argumentin se kisha bindjen time dhe që kishte lindur nevoja për një prokuror, i cili ta shikonte më ftohtë dhe jashtë emocioneve.

Më tej, hetimet i kanë ndjekur prokurorë të tjerë, ku edhe prokurori Gj. K. ka dalë në të njëjtat përfundime me mua.

Duhet theksuar se, referuar ekzaminimit mjekoligjor të kryer pas ekzumimit të kufomës (zhvarrimit), ekspertët mjekoligjorë kanë arritur në të njëjtat përfundime me ato të autopsisë së parë, sipas së cilës, dëmtimet e viktimës janë shkaktuar në momentin e aksidentit dhe brenda

kabinës së automjetit, çka logjikisht e përjashton tërësisht pretendimin për vrasje me paramendum të ngritura nga babai i së ndjerës.

Për ta përfunduar, rruga ligjore e ndjekur si për ngjarjen e vdekjes së të bijës, ashtu edhe lidhur me kallëzimin ndaj meje dhe prokurorëve të tjerë që e kanë ndjekur çështjen pas meje, ka marrë zgjidhje ligjore nga gjykatat me vendim të formës së prerë, ku, sipas vlerësimit të gjykatave në disa shkallë, në veprimet tona procedurale gjatë ushtrimit të funksioneve nuk kanë gjetur elemente kundërligjshmërie, si dhe që ngjarja ka qenë aksidentale dhe jo si një vrasje e paramenduar dhe inskenuar.”

Në konkluzion, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer të gjitha veprimet procedurale të kërkuara, por ai nuk duhej të vendoste pushimin e procedimit penal nr. (***) , datë 04.08.2006, sipas nenit 328/1, germa “dh” të Kodit të Procedurës Penale, sepse i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai, por të procedonte të pandehurin A. N. për veprën penale, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal.

Në Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në pikën 54 parashikohet se: “... **është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.**”

Ndonëse, subjekti i rivlerësimit ka gabuar në këtë çështje, nuk gjendemi përpara parashikimeve të mësipërme.

Ankesa 2

*66. Denoncimi nr. (***) prot., datë 23.01.2018.*

Ky denoncim u referohet 31 subjekteve të rivlerësimit. Ankuesja denoncon disa prokurorë dhe gjyqtarë lidhur me zvarritjen e proceseve gjyqësore që lidhen me çështjen civile të njohjes së paditëses si trashëgimtare e V. N. V., dorëzimin e pasurisë trashëgimore, njohjen e saj si bashkëpronare në 1/2-ën pjesë të të gjithë pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit, babait të saj V. V., sipas listimit të saj nga pala paditëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankuesja, nuk rezultuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ankesa 3

*67. Denoncimi nr. (***) prot., datë 02.02.2018.*

Ky denoncim u referohet 18 subjekteve të rivlerësimit.

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Ankesa 4

*68. Denoncimi nr. (***) prot., datë 08.02.2018.*

Ky denoncim u referohet 12 subjekteve të rivlerësimit.

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Ankesa 5

*69. Denoncimi nr. (***) prot., datë 27.02.2018.*

Ky denoncim u referohet tre personave. Ankuesi denoncon për vendim të padrejtë prokurorin e çështjes për mosfillimin e procedimit penal për falsifikim dokumentacioni arkivor.

Lidhur me kallëzimin penal të paraqitur nga ankuesi është vendosur mosfillimi i hetimeve paraprake për kallëzimin penal nr. (***) nga prokurori N. T.

Në dokumentacionin e paraqitur nuk gjenden fakte për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani.

Ankesa 6

*70. Denoncimi nr. (***) prot., datë 30.05.2018.*

Ky denoncim është vetëm për subjektin e rivlerësimit. Ankuesi shprehet lidhur me zvarritje të procesit dhe aftësitë profesionale.

Shtetasi Xh. O. ka paraqitur pretendime në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj vendimit për pushimin e çështjes penale nr. (***), viti 1998, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, me arsyetimin se veprat penale, objekt i këtij hetimi, janë parashkruar dhe aktualisht nuk mund të ushtrohet ndjekje penale.

Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Stojani, ka kthyer përgjigje, duke sqaruar se ligjshmëria e veprimeve të prokurorit të çështjes, ashtu sikurse vlerësimi i provave janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykata. Prokuroria e Përgjithshme nuk ka kompetencë të ndërhyjë në vendimmarrjen e gjykatave, duke e udhëzuar ankuesin nëse nuk është dakord me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të nenit 329, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, të paraqesë ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi, nuk rezultuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ankesa 7

*71. Denoncimi nr. (***) prot., datë 08.10.2018.*

Ankuesi denoncon subjektin e rivlerësimit, pasi i ka kthyer një përgjigje në mbrojtje të prokurorëve të korruptuar.

Ankuesi i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me një vendim pushimi të çështjes penale nr(***), të vitit 2016, për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, dhe vendimin e mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. (***), të vitit 2016.

Me shkresën nr. (***), datë 10.08.2018, subjekti i rivlerësimit, në detyrën e drejtorit të ndihmës për subjektet e posaçme, mbrojtjes së dëshmitarëve, inspektimit dhe burimeve njerëzore, studimeve, projekteve, ka kthyer përgjigje duke u shprehur se ligjshmëria e veprimeve të prokurorit të çështjes janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykatat.

Kallëzuesit i njihet e drejta e ankimit në gjykatë të këtyre vendimeve brenda 10 ditëve nga marrja dijani sipas parashikimeve të neneve 291/2 dhe 329/1 të Kodit të Procedurës Penale,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nuk rezultuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

72. Në tërësi lidhur me ankesat, subjekti i rivlerësimit sqaron se:

“Për sa u takon ankesave të qytetarëve pranë Komisionit, në mënyrë të përmbledhur dua të them vetëm se, në përgjigjen time kam dashur t’i orientoj qytetarët që pretendimet e tyre lidhur me vendimet e pushimit apo mosfillimit të procedimeve, në respekt të Kodit të Procedurës Penale, duhet t’i ngrenë në gjykatën kompetente, pasi, në parim, veprimtaria hetimore e prokurorit kontrollon nga gjykata.

Prokuroria e Përgjithshme, sipas kuadrit kushtetues e ligjor, nuk ka më asnjë kompetencë hetimore apo kontrolli të kësaj veprimtarie të prokurorëve të shkallëve të para. Thënë ndryshe, nuk kam marrë kompetenca që nuk më janë përcaktuar me ligj, por thjesht kam orientuar palët në mënyrë administrative për t’iu drejtuar organit kompetent që ka për detyrë të shqyrtojë ankimet mbi vendimet e prokurorëve.”.

Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale

73. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

74. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Stojani: “I aftë”.

75. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

76. Gjatë të gjitha fazave të hetimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit.

77. Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar dhe duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar.

78. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë të gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka dhënë shpjegimet e nevojshme.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Stojani, me funksion prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 31.10.2018, ora 13:00.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Brunilda Bekteshi

ANËTAR

Suela Zhegu

RELATORE

Valbona Sanxhaktari

Sekretare gjyqësore

Denisa Kosta